



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Mbështetur në nenin 52.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/ L-040, nenin 48 parag.1 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, nenit 16 të Rregullores për përbërjen, kompetencat dhe rregullat e punës të Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit,

THËRRAS

Mbledhjen e XXIV-të (njëzetekatër - mandati VII) të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **21 maj 2024**, duke filluar nga **ora 10:00**, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, me këtë,

REND TË DITËS

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtura më:
29 shkurt 2024; 28 mars 2024 dhe 17.04.2024
2. Propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2023 në vitin 2024 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore.
3. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi”
4. Propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik pronat e paluajtshme shoqërore nën menaxhimin e AKP-së, dhe atë; -në Zonën Kadastrale Dumnicë e Poshtme, për realizimin e projektit për ndërtimin e Tregut të Kafshëve, dhe -në Zonën Kadastrale Podujevë, për realizimin e projektit për ndërtimin e Tregut të Gjelibër.
5. Propozim vendimi për shpallje në interes të përgjithshëm publik - objektet e ndërtuara në Parcelën me nr.P-71712062-02153-1, Zona Kadastrale Podujevë.
6. Raporti Financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar – mars 2024
7. Draft Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore 2024 – 2026.
8. Informatë për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB për vitin 2023.
9. Propozim Plani i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB për vitin 2024.
10. Raport i punës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, periudha janar-mars 2024.
11. Informatë e Drejtorisë së Bujqërisë Pylttarisë dhe Zhvillimit Rural.
12. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1274-0, ZK Llapashticë e Epërme

- 12.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim
13. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1207-0, ZK Llapashticë e Epërme
- 13.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim
14. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës-2 Lokalet Afariste 50 m2 dhe 55 m2 të ndërtuara në rr. "Skënderbeu" në Njësine kadastrale P-00459-0, ZK Podujevë
- 14.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim
15. Raporti i komisionit për vlerësimin e gjendjes dhe konstatimin e shkallës së rrezikshmërisë së objektit të ndërtuar në periudhën e viteve 1982-1985 me destinim "Shtëpi të Kulturës".

Nr.Prot.01-060/03-0031006/24
Podujevë, datë; 13 maj 2024



Kryesuesi i Kuvendit
Fidmi Hoxha